



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Visar BIBAJ / Ekspert Shqyrtues _____	Data e autorizimit të ekspertit 29.06.2022	Data e dorëzimit të raportit 06.07.2022	Nr. lëndës: 237/22
--	--	---	------------------------------

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Më datën: 28.06.2022, OE “Er – Lis”shpk – Pejë, ka parashtruar ankesë me numër: **237/22**, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “She njëzimi i rrugëve dhe objekteve publike ne fshatra dhe qytetin e Malishevës”, me nr. prokurimi: 62500-22-5465-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Malisheve.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure të negociuar, lloji i kontratës është furnizim, vlera e parashikuar 120 000,00 (kontratë kornize 36 muaj)

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE SIPAS OE ANKUES

Neni 7 I LPP Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 28 I LPP Specifikimet teknike

Neni 69i LPP Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Neni 66 LPP Përshtatshmëria Profesionale

Neni 108/A- paragrafi 9 - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

DEKLARATA DETALE E ANKESES

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Er – Lis”shpk – Pejë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “She njëzimi i rrugëve dhe objekteve publike ne fshatra dhe qytetin e Malishevës”, me nr. prokurimi: 62500-22-5465-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Malisheve.

AK Kuvendi Komunal Malisheve pas Kërkeses për informata shtesë Anexi 5 i DT dt 22.06.2022 :

Tek Kërkesat e përshtatshmërisë keni kerkuar pika

1. 3.3. Ekspert i Licencuar për siguri dhe shëndet ne pune ne profilin e Komunikacionit, i Licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Ju lutem te sqaroni se perse ju nevojitet nje ekspert i till dhe a mendoni se eshte ne kundërshtim me LPP -ne Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

2. Po ashtu tek Specifikimet teknike Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME nuk e keni plotësuar fare. Ju lutem na sqaroni dhe plotësoni dosjen e tenderit, Me respekt ER-LIS SHPK nuk na ka kthyer përgjigje.

Kemi bërë kërkesë për Rishqyrtim me te njejtat pika si ne Kërkesen per Informata shtesë me dt 23.06.22 por te njejten dite (brenda 2h) na ka njoftuar VENDIM MBI REFUZIMTN E KERKESES PER RISHQYRTIMsipas (Neni 53.6iLPP-se) site PA BAZUARporpa asnjësqarim. Kërkesa per REishqyrtim

ne afat ligjor kerkojme nga Ju që të merrni parasyshtë Kërkesat tona në mënyrë që DT të jetë në harmoni të plote me Legjislacionin ne fuçi.

1. Kerkoj nga Ju që të kompletëni Dosjen e Tenderit Specifikimet teknike të detyrueshme - Aneksi 1.

Specifikacionet teknike të detyrueshme	3.1	Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuese për qëllimii ofruar të kontratës, duke përfshirë: a. Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat pën me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit;
--	-----	---

Kurse, tek Aneksi I nuk keni sqaruar, përmendur apo edhe plotsuar Aneksin I

Ndërsa:

2. Tek Kërkesat për mundësi teknike ne piken 3.3 keni kerkuar *3.3. Ekspert i Licencuar për siguri dhe shëndet ne pune ne profilin e Komunikacionit, i Licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Dëshmi e dokumentuar Licence te noterizuar.*

Mendoj se eshte e pa nevojshme kërkesa e ekspertit te tillë, por mund të jetë e qëllimshme ne menyre që të favorizojë ndonje kompani. (Ne kundërshtim me LPP-në)

Duke e ditur se as tenderat e ministrise se transportit e te cilet kan te bejne me Sinjalizimin e rrugeve Regjionale Auto-rrugeve etj në kërkesat e Dosjeve te tyre nuk kan parapa një ekspert të tillë. Andaj kërkojm nga JU që të përmirësoni Kërkesat e DT në mënyrë që të kemi mundësi të konkurojmë të barabart të gjitha kompanit që merren me sinjalizim.

Duke marr parasyshtë që AK nuk ka marrë mundin të përgjigjet në Kërkesen për informacione shtesë dt 22.06.2022 e po ashtu edhe në Kërkesen për Rishqyrtim dt 23.06.2022 apo vazhdimin e afatit për dorëzim, me sqarime sado të vogla e gjitha kjo në Kundërshtim me Legjislacionin në fuçi, nga OSHP Kërkoj që të marre këtë:

VE N DIM

III. URDHËROJ AK që të bëjë përmirsimin e Dosjes se Tenderit. DT për Aktivitetin e Prokurimit: Shenjëzimi i rrugëve dhe objekteve publike në fshatrat dhe qytetin e Malishevës me nr te prok: 62500- 22-5465-1-2-1

KRITERET PËR VLERËSIM

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

3.3. Ekspert i Licencuar për siguri dhe shëndet ne pune ne profilin e Komunikacionit, i Licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

DESHMIA DOKUMENTARE

- Licenca e Noterizuar për pikën 3.3.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES.

Ska

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Er – Lis”shpk – Pejë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “She njëzimi i rrugëve dhe objekteve publike ne fshatra dhe qytetin e Malishevës” , me nr. prokurimi: 62500-22-5465-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Malisheve.

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

NA

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

NA

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

Sqarim Hyrës: Autoriteti Kontraktues - “Komuna Malisheve”, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës është furnizim (kontratë kornizë 36 muaj) me vlerë të mesme. Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit për te kontratë.

- Kundër të njëjtit njoftimi parashtruesi i ankesës “Er Lis” shpk - Peje, më datën 23.06.2022, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pran AK-se, me pretendimet e njëjta ankimore si ne ankesën e dorëzuar ne OSHP. Përderisa AK – Komuna Malisheve, përmes vendimit të datës se njëjte refuzon kërkesën si të pa bazuar, me arsyetimin se nuk ndryshohen kushtet e njoftimit për kontrate dhe dosjes se tenderit.

Përgjigjeje në pretendimin ankimore 1 (neni 113) : Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lendes kundrejt pretendimeve ankimore sqarojmë se parashtruesi i ankesës pretendimet i ka ngritur kundrejt kërkesave të kualifikimit, përkatësisht kundër pikës 3.1, të FDT-se ku AK , ka kërkuar deklarate për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në aneksin 1”

- Sipas dosjes se tenderit përkatësisht aneksi 1, nuk përmban specifikacione teknike të detyrueshme, rrjedhimisht pretendimi dhe kërkesa e parashtruesit të ankesës ka qenë e qartë dhe konkrete, megjithatë AK, nuk e ka trajtuar fare të njëjtin pretendim.

Pretendimi tjetër ndërlidhet me pozicionin 3, të kërkesave të kapacitetit teknik dhe profesional ku AK – Komuna Malisheve ka kërkuar: “*Ekspert i Licencuar për siguri dhe shëndet në punë në profilin e Komunikacionit, i Licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*”. Është kërkuar në arsyetim për kërkesë të tillë dhe është konsideruar si kërkesë që e kufizon konkurrencën dhe bie ndesh me parimet e përgjithshme të Prokurimit Publik. Edhe për këtë pikë Autoriteti Kontraktues – Komuna Malisheve nuk ka dhënë arsyetimi sic obligohet me dispozitat e nenit 108/A, të LPP-se.

Paragrafi 9, i nenit 108/A, te LPP-se përcakton: “Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Për më tepër autoriteti kontraktues mund të pengojë procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim”.

- Se bashku me raport si prove gjeni kopjen e vendimit kundrejt kërkesës për ri shqyrtim dhe Aneksin 1 te dosjes se tenderit

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues, Er – Lis” shpk – Pejë, të aprovohet ne tërësi si e bazuar dhe te obligohet AK – Komuna Malisheve qe lenden ta kthej ne Ri shqyrtim dhe ne ri vendosje siç parashihet me dispozitat e nenit 108/A, te LPP-se.

Raporti ti dorëzohet:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| - Autoritetit Kontraktues | - Komuna Malisheve. |
| - Panelit Shqyrtues | - OSHP. |
| - OE ankues | - Er – Lis” shpk – Pejë. |

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Er – Lis”shpk – Pejë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “She njëzimi i rrugëve dhe objekteve publike ne fshatra dhe qytetin e Malishevës” , me nr. prokurimi: 62500-22-5465-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Malisheve.